



IOM International Organization for Migration
OIM Organisation Internationale pour les Migrations
OIM Organización Internacional para las Migraciones



Seminar mbi Krijimin e Politikave Efektive të Migracionit për Qëllime Punësimi në Vendet e Origjinës e të Destinacionit dhe Bashkëpunimin Ndërshtetëror në Ballkanin Perëndimor

9-10 shkurt 2009, Tiranë

Sfondi

Pavarësisht nga historia e përbashkët, Evropa Juglindore përfaqëson një rajon me problematikë shumë të ndryshme për sa i përket çështjeve të migracionit. Disa shtete në rajon përballen me një shkallë të lartë papunësie dhe fluks shumë të madh emigrantësh, ndërsa disa shtete të tjera kanë nevojë për imigrantë për të plotësuar vendet e krijuara si pasojë e mungesave në sektorët e tregut që po zhvillohen në ekonominë e tyre. Shumë nga emigrantët e rajonit udhëtojnë drejt Gjermanisë, Austrisë, Italisë e Greqisë, por shumë lëvizje ka edhe brenda për brenda rajonit, si pasojë e kulturës së përbashkët, lidhjeve të mëparshme të tregut në kontekstin e ish-Jugosllavisë dhe lidhjeve familjare.

Mundësia e krijimit të rrugëve të reja të ligjshme të migrimit për qëllime punësimi për migrantët nga Evropa Juglindore, dhe hartimi i politikave efektive të migracionit për qëllime punësimi nga vendet e rajonit janë çështje që janë diskutuar në një konsultim jo zyrtar në Zagreb në shkurt 2006, i cili përfshinte ministrinë e punës dhe çështjeve sociale. Gjatë sesionit të konsultimit u identifikuan shume ide të gabuara/keqkuptime si p.sh. në lidhje me marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe, apo në lidhje me çështje të tjera mbi përfshirjen e agjencive të punësimit në tregun e zi të punës dhe rrjetet e trafikantëve.

Seminari mbi Krijimin e Politikave të Migracionit për Qëllime Punësimi në Vendet e Origjinës dhe të Destinacionit ka për qëllim të pajisë politikëbërësit dhe praktikantët me mjetet për menaxhimin efektiv të migracionit për qëllime punësimi nga dhe drejt vendeve të tyre. Kjo do të arrihet nëpërmjet familjarizimit me politikat efektive dhe praktikat e kryera deri tani dhe nëpërmjet diskutimeve se si mund të përshtaten apo zhvillohen politika të veçanta në përputhje me situatat specifike të migracionit.

Ky seminar do të ndjekë strukturën e *Manualit mbi Krijimin e Politikave Efektive të Migracionit për Qëllime Punësimi në Vendet e Origjinës dhe të Destinacionit* të përgatitur nga IOM-i në bashkëpunim me ILO-n dhe OSBE-në. Objektivi kryesor i Manualit është të ndihmojë vende të ndryshme në përpjekjet e tyre për të hartuar përfaqset dhe për të gjetur zgjidhjet e duhura për një menaxhim më të mirë të migracionit për qëllime punësimi dhe flukseve të migracionit për qëllime punësimi, si në vendet e origjinës, ashtu edhe në ato të destinacionit.

Në pjesën e parë të seminarit do të trajtohen politikat e lidhura me migracionin në vendet e origjinës së migrantëve, ndërsa pjesa e dytë do të përqendrohet në diskutimet e politikave të vendeve të destinacionit. Sesioni përfundimtar i seminarit do të fokusohet në mjetet praktike të zhvillimit të bashkëpunimit ndërshtetëror mbi çështje që lidhen me migrimin për qëllime punësimi brenda rajonit të Ballkanit Perëndimor. Një vëmendje e veçantë do t'u kushtohet prezantimeve dhe diskutimeve të politikave konkrete dhe shkëmbimit të praktikave të mira.

Pjesëmarrësit

Fokusi i Trajnimit Rajonal do të jenë vendet e Evropës juglindore si Shqipëria, Bosnje dhe Hercegovina, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Kosova, Mali i Zi dhe Serbia. Pjesëmarrësit do të përzgjidhen nga ministrinë e punës, ministrinë e brendshme, dhe ministrinë e tjera, organizatat e punëtorëve dhe punëdhënësve, shoqatat e migrantëve si dhe ekspertë të pavarur.

Gjuhët e huaja

- anglisht
- maqedonisht
- shqip
- boshnjake/kroate/serbe/malazeze



IOM International Organization for Migration
OIM Organisation Internationale pour les Migrations
OIM Organización Internacional para las Migraciones



PROGRAMI

Hotel Tirana
Sheshi "Skënderbej" 8
Tiranë

Dita 1: E hënë, 9 shkurt 2009

08:00 – 09:00 **Regjistrimi**

HAPJA

09:00 – 10:00 **Fjala e hapjes**

- Z. Andrea Marto, Sekretar i Përgjithshëm
Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
- Z. Luigi Brusa, I Ngarkuari me Punë, Delegacioni i Komisionit Evropian në Shqipëri
- Përfaqësues nga organizatat/qeveritë donatore

Migracioni me qëllim punësimi në vendet e Europës Juglindore - sfidat dhe tendencat e së ardhmes (prezantim i projektit)

- Zj. Nicoletta Giordano, Shefe e Misionit IOM, Tiranë, Shqipëri

SESIONI 1

10:00 – 11:15 **Kuadri Ligjor Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Punëtorëve Migrantë**

Drejtues: Z. Daniel Züst, Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim, Shqipëri

Folës:

- Z. Ryszard Cholewiński, Specialist Migracioni, IOM: *Të drejtat e punëtorëve migrantë në një kontekst më të gjerë evropian dhe ndërkombëtar*
- Z. Patric Taran, Ekspert për Migracionin, ILO: *Konventat e ILO-s dhe kuadri shumëpalësh i migracionit për qëllime punësimi*
- Zj. Agnieszka Weinar, Specialist për Politikën, Komisioni Evropian, Drejtoria e Përgjithshme e Drejtësisë, Lirisë dhe Sigurisë (DG JLS): *Politikat aktuale të BE-së lidhur me migracionin për qëllime punësimi – aspektet e brendshme dhe të jashtme*
- Pyetje dhe përgjigje

11:15 – 11:45 **Pushim për Kafë**

SESIONI 2

11:45 – 12:45 **Reagimet ndaj Politikave të Shteteve të Origjinës mbi Migracionin për Qëllime Punësimi**

Drejtues: Z. Gabriel Leonte, Këshilltar për Ekonominë dhe Mjedisin, OSBE

Folës:

- Zj. Elizabeth Warn, Specialiste për Migracionin e Punës, IOM
Politikat e migracionit për qëllime punësimi në vendet e origjinës.
- Z. Gabriel Leonte, Këshilltar për Ekonominë dhe Mjedisin, OSBE
Përfaqsj dhe kontributi i OSBE në fushën e migracionit për motive punësimi
- Zj. Ana Milicevic Pezelj, Drejtore e Departamentit të Organizimit, Arsimit dhe Publikimit, Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kroacisë
Migracioni për qëllime punësimi dhe roli i sindikatave – Eksperienca kroate
- Pyetje dhe përgjigje

12:45 – 14:00 **Dreka**

14:00 – 15:00 **Prezantimet e Shteteve (10 minuta)**

Drejtues: Z. Stojan Trajanov, Këshilltar, Ministria e Punës dhe Politikave Sociale, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë

Folës:

- Shqipëria: Zj. Olijana Ifti, Drejtore e Drejtorisë së Politikave të Migracionit, Kthimit dhe Riintegrimit, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
- Bosnja-Hercegovina: Zj. Radojka Tesanovic, Konsulente e Lartë për Çështjet e Punës, Ministria e Çështjeve Civile
- Kosova: Z. Hafiz Leka, Drejtor i Drejtorisë së Punës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
- IRJ e Maqedonisë: Z. Stojan Trajanov, Këshilltar, Ministria e Punës dhe Politikave Sociale
- Pyetje dhe përgjigje

SESIONI 3

15:00 – 16:30 **Reagimet ndaj Politikave të Vendeve të Destinacionit mbi Migracionin për Qëllime Punësimi**

Drejtues: Z. Flavio Lovisolò, Drejtor, Bashkëpunimi Italian për Zhvillim në Shqipëri

Folës:

- Mr Patrick Taran, Ekspert për Migracionin, ILO
Përmbledhje e reagimeve ndaj politikave të vendeve të destinacionit
- Z. Prosper Dombele, Bashkëpunëtor Shkencor, Zyra Federale Zvicerane për Migracionin dhe Refugjatët, Zvicër: *Integrimi dhe tregu i punës në Zvicër*
- Pyetje dhe përgjigje

16:30 – 17:00 **Pushim për Kafë**

SESIONI PLENAR

17:00 – 17:45 **Diskutim**

Cilat janë tri çështjet më kryesore me të cilat përballet vendi juaj aktualisht dhe me të cilat do të përballet në të ardhmen e afërt për sa i përket administrimit dhe politikave të migracionit me qëllim punësimin?

Drejtues: Z. Patrick Taran, Ekspert për Migracionin, ILO

17:45 **Përmbledhje e Ditës së Parë**

19:00 **Darkë**

Dita 2: E martë, 10 shkurt 2009

09:00 – 09:4 **Vazhdimi i SESIONIT 3: Prezantimet e Shteteve**

Drejtues: Zj. Marija Knezevic Kajari, Shefe Sektorit të Punësimit dhe Tregut të Punës, Ministria e Ekonomisë, Punës dhe e Çështjeve të Biznesit, Kroacia

- Mali i Zi: Zj. Zorica Spasojevic, Këshilltare Ligjore, Agjencia e Punësimit
- Serbia: Zj. Dragica Ivanovic, Drejtore e Drejtorisë së Politikave Aktive të Punësimit, Ministria e Ekonomisë dhe e Zhvillimit Rajonal
- Kroacia: Zj. Ljiljana Maglic Rados, Shefe e Sektorit për Statusin e Shtetasve të Huaj, Ministria e Brendshme, dhe Zj. Ivanka Zlatec, Drejtore e EURES, Shërbimi Kroat i Punësimit
- Pyetje dhe Përgjigje

SESSIONI 4

10:00 – 11:00 **Bashkëpunimi dypalësh për migracionin/projekte: shembuj praktikë**

Drejtues: Z. Abdulah Abdic, Shef i Sektorit të Migracionit, Vizave, dhe Pranimit, Ministria e Brendshme, Mali i Zi

Folës:

- Zj. Silvia Achille, Departamenti i Përgjithshëm i Migracionit, Ministria e Punës, Shëndetit dhe Politikave Sociale, Itali: *Marrëveshjet Dypalëshe – Kuadri Ligjor*
- Z. Ugo Melchionda, Ekspert i Migracionit të Punës, IOM Romë: *Strategjia e IOM-it për migracionin me qëllim punësimi dhe eksperiencia në kuadrin e legjislacionit italian*
- Zj. Gemma Pinyol, Koordinatore e Programit të Migracionit, Qendra për Informacion Ndërkombëtar dhe Studimeve mbi Zhvillimin, Spanjë: *Marrëveshjet dypalëshe të punës – eksperiencia spanjolle*
- Pyetje dhe përgjigje (15 min)

GRUPE PUNE

11:00 – 12:30 **Grupi i Punës I**

Punë brenda rajonit të Ballkanit Perëndimor: Bashkëpunimi ndërmjet agjencive qeveritare mbi çështjet të migracionit me qëllim punësimin

- Marrëveshje ndërmjet shërbimeve lokale të punësimit në lehtësimin e fluksit të informacionit.

Moderator: Zj. Elizabeth Warn, Specialiste Migracioni, IOM

Grupi i Punës II

Të punohet me vendet e destinacionit në BE

- Marrëveshjet bilaterale të punës dhe zbatimi i tyre.

Moderator: Z Ryszard Cholewinski, Specialist Migracioni, IOM

12:30 – 14:00 **Dreka**

SESSIONI PERFUNDIMTAR

14:00 – 15:00 **Raportimet e Grupeve të Punës**

Sesion Plenar

Konkluzionet nga Z. Adam Pinos, Konsull, Ambasada e Republikës Çeke në Shqipëri dhe organizatorët



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra



Federal Office
for Migration
and Refugees



GOVERNMENT
OF LIECHTENSTEIN